



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1587/8 prot.

Datë 24.06.2026

V E N D I M
Nr. 857/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 24.06.2026 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Vendim për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar të ankesës së BOE “O.E.S DISTRIMED” SHPK & “EUROMED” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me REF-77193-02-24-2026 me objekt: “Blerje materiale mjekimi konsumabel dhe kirurgjikale”, me fond limit 16,341,122.67 (gjashtëmbëdhjetë milion e treqind e dyzetë e një mijë e njëqind e njëzetë e dy pikë gjashtëdhjetë e shtatë) Lek pa TVSH, zhvilluar në datën 05.05.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.

Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “GAMMA” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me REF-77193-02-24-2026 me objekt: “Blerje materiale mjekimi konsumabel dhe kirurgjikale”, me fond limit 16,341,122.67 (gjashtëmbëdhjetë milion e treqind e dyzetë e një mijë e njëqind e njëzetë e dy pikë gjashtëdhjetë e shtatë) Lek pa TVSH, zhvilluar në datën 05.05.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara

Ankimues:

BOE “O.E.S DISTRIMED” SHPK me Nipt K31520054N dhe adresë:, Bulevardi Bajram Curri, pallati Kastrati, Tiranë

&

“EUROMED” SHPK me Nipt K71718012P dhe adresë:
Bulevardi “Bajram Curri”, Pranë Marternitetit të ri, Pll 298, H16,
1004, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Operatori i Blerjeve të Perqendruara.
Adresa: Rruga “Rreshit Çollaku” Godina Nr. 6/337, Tiranë (në
krah të Gjykatës së Lartë)

Subjekte të Interesuara: Operatori ekonomik “GAMMA” SHPK me Nipt K31510153H
dhe adresë:, Njësia Administrative nr.8, Rruga “Dervish Hekali”,
Ndërtesa nr.8, Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar,
Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për
miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar,
Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë
13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe
funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i
Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë
5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për
Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të
Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga
COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me
shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e
lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje
me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit
Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye
legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe
njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në
ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.4. Operatori ekonomik ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

I.5. Operatori ekonomik “GAMMA” SHPK nuk ka respektuar kushtet formale për të bërë të mundur ushtrimin e të drejtës së ankimit për vendimin e dhënë në lidhje me ankesën për këtë procedurë prokurimi.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 25.02.2026, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me REF-77193-02-24-2026 me objekt: “Blerje materiale mjekimi konsumabel dhe kirurgjikale”, me fond limit 16,341,122.67 (gjashtëmbëdhjetë milion e treqind e dyzetë e një mijë e njëqind e njëzetë e dy pikë gjashtëdhjetë e shtatë) Lek pa TVSH, zhvilluar në datën 05.05.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Perqendruara..

II.2. Në datën 05.05.2026, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor dhe sistemit të prokurimeve elektronike rezulton se në datën 07.05.2026, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “ GAMMA” SHPK	12,996,200 lekë	kualifikuar
2. BOE “ O.E.S DISTRIMED” SHPK & “EUROMED” SHPK	16,185,330 lekë	kualifikuar

II.4. Në datën 13.05.2026, autoriteti kontraktor ka publikuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik “Njoftimin e Fituesit Paraprak” për procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi.

II.5. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 16.09.2025 nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankesa me numër ankimimi elektronik A/2026/6592 datë 21.05.2026 dhe me nr.1587 prot., datë 21.05.2026 e BOE “O.E.S DISTRIMED” SHPK & “EUROMED” SHPK nëpërmjet së cilës kundërshton vendimin e komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “GAMMA” SHPK në këtë procedurë prokurimi me pretendimin si më poshtë:

“...- 1. Bazuar në Regjistrin Kombëtar të Pajisjeve Mjekësore të regjistruara në Republikën e Shqipërisë, publikuar në faqen zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore (AKBPM), në përputhje me ligjin nr. 89, datë 17.07.2014 “Për pajisjet mjekësore”,

operatori ekonomik GAMMA rezulton që të ketë regjistruar vetëm produkte konsumi të cilat i përkasin fushës Laboratorike (IVD) dhe në asnjë rast materiale mjekësore për përdorim spitalor dhe kirurgjikal, siç janë edhe artikujt objekt prokurimi. Gjithashtu referuar regjistrin e kontratave publike ne regjistrin e Agjencise se Prokurimit Publik, rezulton qe operatori ekonomik Gamma nuk ka asnjë kontrate me materiale mjekesore apo kirurgjikale. Kujtojmë që artikujt e kësaj procedure janë produkte mjekësore specifike kirurgjikale dhe të një rëndësie të veçantë klinike dhe jetike, të cilat përdoren në salla operacioni gjate procedurave kirurgjikale, departamentet e

anestezi-reanimacionit, ORL, urgjencës etj. Këto produkte duhet të konsiderohen dhe vlerësohen me përgjegjësi të lartë, pasi kanë përdorim të drejtpërdrejtë ne trupin e pacienteve të rritur dhe pediatrikë. Fakti që operatori Gamma nuk ka regjistruar në Shqiperi asnjë material mjekesor apo kirurgjikal të tillë apo të ngjashme në pesë vitet e fundit (sipas ligjit nr. 89, datë 17.07.2014 “Për pajisjet mjekësore”) na jep të drejtën për të shfaqur dyshimet tona të arsyeshme që ky operator nuk e plotëson pikën 2.3.1 të DST.

Rëndësia e këtyre materialeve, siç janë suturat (penjtë kirurgjikalë), meshat (rrjetat) kirurgjikale, sondat gastrike, agët spinale, kanjulat intravenoze, veshjet dhe bezet kirurgjikale apo edhe sterilizuesit e instrumenteve që përdoren në kirurgji, qëndron në faktin se ato hyjnë në kontakt të drejtpërdrejtë me indet e brendshme gjatë kirurgjive apo sistemin vaskular, urinar, sistemin e frymëmarrjes etj. Cilësia e lartë e suturave dhe meshave kirurgjikale garanton që organizmi ta pranojë materialin e huaj pa krijuar reaksione inflamatore të rrezikshme, ndërsa sterilizimi rigoroz i instrumenteve me solucionet e duhura apo cilesia e veshjeve te kirurgeve dhe i bezeve kirurgjikale parandalon infeksionet spitalore që shpesh rezultojnë fatale. Për këtë arsye, legjislacioni i prokurimit publik ka parashikuar që ofruesit e këtyre materialeve duhet të kenë eksperiencë të ngjashme, në mënyrë që të garantohet cilësia e jetës së pacientëve.

Sa më sipër, duke qenë se operatori GAMMA ka të regjistruar vetëm materiale laboratorike diagnostikuese apo materiale ndihmëse jo sterile, si dhe referuar objektit të këtij prokurimi “Blerje materiale mjekimi konsumabël dhe kirurgjikale”, kërkojmë nga KSHA dhe KPP të ribëjnë një analizë të thelluar dhe krahasimore të furnizimeve të dorëzuara nga ana e operatorit ekonomik “Gamma” dhe jo vetëm të volumit te furnizimeve në vlerë financiare. Vlen të theksohet fakti se edhe Direktivat e Bashkimit Evropian mbi Certifikimin e materialeve CE, i klasifikojnë materialet mjekësore dhe ato laboratorike si jo të ngjashme, duke i certifikuar nëpërmjet dy direktivave të ndryshme (MDD/MDR per materiale dhe pajisje mjekesore dhe IVD per materiale dhe pajisje laboratorike).Gjithashtu referuar Vendimit te KPP 212/2026 date 09.02.2026, Komisioni i Prokurimit Publik ka vendosur nje standard mbi interpretimin e furnizimeve te ngjashme kur ato nuk jane realizuar Brenda fushes se objektit te prokurimit.

2. Duke qenë se në SPE nuk jepet informacion mbi mënyrën e ofertimit të operatorëve ekonomikë nëse kanë marrë pjesë si BOE apo nëse janë mbështetur në kapacitetin e ndonjë operatori tjetër, si dhe në bazë të analizës së mësipërme që OE Gamma operon kryesisht në fushën laboratorike, kemi dyshimet tona te arsyeshme se OE Gamma mund të ketë marrë pjesë në këtë procedurë prokurimi duke bashkëpunuar me OE të tjerë në tentativë për të plotësuar kriterin 2.3.1. Për këtë arsye, kërkojmë nga KSHA dhe KPP që të verifikohet nëse OE Gamma ka ofertuar si BOE dhe të bëhet vlerësimi i furnizimeve të ngjashme në bazë të përqindjes që ka

deklaruar për secilin OE. Në rast se OE GAMMA është mbështetur në kapacitetet e ndonjë OE tjetër, kërkojmë që të verifikohet nëse është deklaruar përqindja e mbështetjes konform VKM Nr. 285, datë 19.5.2021, Neni 90, Pika 2, ne

menyre që vlerësimi të bëhet konform përqindjes së deklaruar, pasi mbështetja në kapacitetet e një operatori tjetër është e limituar deri në maksimumi 50% dhe një gjë e tillë duhet të deklarohet saktësisht në Shtojcën 9 sic e parshikon VKM Nr. 285, datë 19.5.2021, Neni 90, Pika 2.

3. Duke qenë se OE GAMMA nuk ka eksperiencë në furnizimin e materialeve mjekësore dhe sidomos atyre kirurgjikale, kemi dyshimet tona të arsyeshme se ky operator nuk posedon informacionin e duhur mbi certifikimin e materialeve mjekësore sipas direktivave CE MDD/MDR, kjo edhe për shkak të mungesës së eksperiencës në regjistrimin e këtyre materialeve pranë AKBPM. Disa nga artikujt kirurgjikalë pjesë e objektit të prokurimit, siç janë suturat kirurgjikale dhe meshat kirurgjikale, klasifikohen në klasën më të lartë të pajisjeve mjekësore “Klasa e riskut III”. Për këtë arsye kërkojmë nga KSHA dhe KPP që të verifikohet në mënyrë të detajuar cdo certifikim CE (nën rregulloren MDR) për të gjitha materialet e ofertuara nga OE Gamma në plotësim të kriterëve teknike dhe kualifikuese.ose nese jane paraqitur Certifikata MDD te shoqeruara me “Notified Body Confirmation Letter” nga Enti Certifikues ne zbatim te rregullores se Bashkimit European mbi vlefshmerine e Certifikatave MDD gjate periudhes se tranzicionit ne direktiven MDR.

4. Kërkojmë gjithashtu që të verifikohet plotësimi i specifikimeve teknike nëpërmjet katalogëve të prodhuesve të paraqitur nga OE Gamma për të gjithë artikujt e ofertuar në këtë procedurë prokurimi, dhe në veçanti të materialeve kirurgjikale siç janë kanjulat intravenoze, aget spinale, suturat kirurgjikale, meshat kirurgjikale, veshjet dhe bezet kirurgjikale që përdoren në sallat e operacioneve si dhe dizinfektatet dhe sterilizuesit e instrumentave kirurgjikale. Ky verifikim është i domosdoshëm për të garantuar që produktet e ofertuara i përgjigjen kërkesave të Autoritetit Kontraktor dhe standardeve të sigurisë spitalore si dhe për të siguruar një trajtim dhe vlerësim të barabartë të operatoreve ekonomik në procedurat e prokurimit.

Kërkesat e mesiperme bazohen në parimin e barazisë së trajtimit të operatorëve ekonomikë, si dhe në nevojën për të siguruar një proces të drejtë dhe të bazuar në prova të dokumentuara, konform legjislacionit në fuqi për prokurimin publik.

Një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, të gjithë operatorët ekonomikë duhet të jenë në kushte të barabarta si kur përgatisin ofertat e tyre ashtu edhe kur bëhet vlerësimi i tyre.

Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyruese për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi përsa kohë i kanë pranuar ato.

Duke marrë parasysh rëndësinë e këtij elementi në vlerësimin e ofertës dhe kualifikimit të OE-së në fjalë, kërkojmë që verifikimi të kryhet në mënyrë rigorozë dhe transparente kundrejt nesh ku cdo mungesë të trajtohet në përputhje me nenet përkatëse të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Nga sa parashtruam me sipër, kërkojmë skualifikimin e ofertes paraqitur nga OE “GAMMA” si një oferte që nuk përmbush kriteret dhe specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentat e tenderit.”

II.6. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr. 1587/1 prot., datë 22.05.2026, me kriteret për të cilat operatori ekonomik BOE “O.E.S DISTRIMED” SHPK & “EUROMED” SHPK me anë të ankesës së tij, pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “GAMMA” SHPK, pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

II.7. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, u konstatua, se në datën 25.05.2026 pranë Komisionit Prokurimit Publik është protokolluar me shkresën nr. 1587/2 prot “Formulari i Paraqitjes së Argumentave nga Operatori Ekonomik i Interesuar “GAMMA” SHPK”, në përputhje me nenin 113 të ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “BOE “O.E.S DISTRIMED” SHPK & “EUROMED” SHPK lidhur me kualifikimin e operatorit ekonomik “GAMMA” SHPK.

II.8. Nëpërmjet shkresës nr.832/23 prot, datë 03.06.2026, protokolluar me tonën me nr. 1587/3 prot, datë 04.06.2026 (ardhur nëpërmjet sistemit elektronik), dhe me nr. 1587/4 prot, datë 04.06.2026 (ardhur nëpërmjet shërbimit postar) është depozituar nga autoriteti kontraktor akti i trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues (vendimi i KSHA-së) nga ku rezulton se autoriteti kontraktor ka vendosur pranimin e pjesshëm të ankesës së operatorit ekonomik ekonomik “BOE “O.E.S DISTRIMED” SHPK & “EUROMED” SHPK dhe konkretisht :

“....Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, pasi mori në shqyrtim dokumentacionin e paraqitur në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga Operatori ekonomik “GAMMA” shpk, konstatoi se për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, rezulton se OE ka paraqitur faturat përkatëse tatimore të shitjes:

- Fatura Nr. 22 me vlerë 1,079,020 lekë pa TVSH lëshuar datë 26.02.2025;

Fatura Nr. 41 me vlerë 446,679 lekë pa TVSH lëshuar më datë 24.03.2025;

- Fatura Nr. 97 me vlerë 115,365.60 lekë pa TVSH lëshuar më datë 10.06.2025;

- Fatura Nr. 252 me vlerë 764,359 lekë pa TVSH lëshuar më datë 09.07.2024;

- Fatura Nr. 24 me vlerë 2,063,301 lekë pa TVSH lëshuar më datë 28.02.2025;

- Fatura Nr. 251 me vlerë 2,219,307 lekë pa TVSH lëshuar më datë 03.07.2024;
- Fatura Nr. 3 me vlerë 1,813,340 lekë pa TVSH lëshuar më datë 11.01.2023;
- Fatura Nr. 316 me vlerë 970,000 lekë pa TVSH lëshuar më datë 14.10.2024;
- Fatura Nr. 89 me vlerë 975,000 lekë pa TVSH lëshuar më datë 04.06.2025;
- Fatura Nr. 5 me vlerë 356,140 lekë pa TVSH lëshuar më datë 18.03.2025.

Nga shqyrtimi i këtyre faturave konstatohet se përmbushja e kërkesës së përcaktuar sipas kapacitetit teknik për p'ërvojën e mëparshme të ngjashme në të trija aspektet e saj, konkretisht ngjashmërinë me objektin e procedurës së prokurimit, vlerën e përllogaritur si dhe afatin kohor për ekzekutimin e furnizimeve, plotësohet nga Faturat me Nr. 316 dhe me Nr. 89.

Referuar Faturave me Nr. 97, me Nr. 24, me Nr. 41, me Nr. 5 si dhe me Nr. 252 evidentohet se artikujt objekt të faturave nuk janë të ngjashëm me artikujt objekt të procedurës së prokurimit e si r edhe këto fatura nuk do të përllogariten në totalin e shumatores së dëshmime U ngjashme.

Ndërsa në lidhje me Faturën Nr. 3, e cila daton më 11.01.2023, qartazi evidentohet se nuk është realizuar gjatë 3 (tri) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës (theksojmë se njoftimi kontratës daton më 25.02.2026). Për këtë arsye kjo faturë nuk do të përllogaritet në totalin e shumatores së dëshmime të ngjashme.

Nga shqyrtimi i Faturës me Nr. 22 konstatohet se vlera e artikujve të ngjashëm me objektin e prokurimit është 435,408 lekë pa TVSH;

Nga shqyrtimi i Faturës me Nr. 251 konstatohet se vlera e artikujve të ngjashëm me objektin e prokurimit është 759,708 lekë pa TVSH.

Nga sa më lart cituar, konstatohet se vlera e përllogaritur e faturave të vlefshme të paraqitura, të cilat konsiderohen të ngjashme me objektin e prokurimit konsiston në vlerën totale prej 3,140,116 lekë pa TVSH.

Pra, Operatori ekonomik "GAMMA" shpk nëpërmjet faturave të paraqitura në S.P.E nuk arrin të provojë përvojën e ngjashme të realizuar gjatë 3 (tri) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, pasi vlera e faturave të përllogaritura nuk arrin masën e përcaktuar në DT, konkretisht 39 % e vlerës së fondit limit.

Në lidhje me pretendimin e ankimuesit ku argumentohet se: Në rast se OE GAMMA është mbështetur në kapacitetet e ndonjë OE tjetër, kërkojmë që të verifikohet nëse është deklaruar përqindja e mbështetjes Conform VKM Nr. 285 datë 19.05.2021, Neni 90, pika 2, në mënyrë që vlerësimi të bëhet Conform përqindjes së deklaruar, pasi mbështetja në kapacitetet e një operatori tjetër është e limituar deri në maksimumi 50 % dhe një gjë e tillë duhet të deMarohet saktësisht në Shtojcën 9 sid e parashikon VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, Neni 90, pika 2. ... ", KSHA

Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit të publikuara për procedurën e prokurimit objekt ankimi, KSHA konstaton se Autoriteti Kontraktor, OBP sha, në pikën 2.16 të Seksionit 2 të DT ka lejuar Operatorët ekonomikë ofertues që të mbështeten në kapacitetet e subjekteve të tjera.

Gjithashtu Në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, Pjesa I, në Seksionin përkatës në pikën B “Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik” OE ka deklaruar si subjekt mbështetës shoqërinë “SoLed” shpk për përmbushjen e kërkesës mbi përvojën e ngjashme.

Në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Kreu XI, Neni 90, pika 4 është parashikuar se: “4. Në qdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti Kontraktor.”

E drejta e operatorit ekonomik për t'u mbështetur në kapacitetet e subjekteve të tjera është e njohur dhe e garantuar nga legjislacioni i prokurimit publik, si një instrument që synon të nxisë konkurrencën dhe të zgjerojë pjesëmarrjen në procedurat e prokurimit. Nëpërmjet kësaj të drejte, Operatori ekonomik mund të përdorë burimet dhe aftësitë e subjekteve mbështetëse për të përmbushur kërkesat e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor, pavarësisht natyrës juridike të marrëdhënies ndërmjet tyre. Ushtrimi i kësaj të drejte nuk është absolut, por i nënshtrohet kushteve dhe kufizimeve të përcaktuara në ligj dhe në dokumentet e tenderit, me qëllim garantimin e seriozitetit të ofertës, përgjegjshmërisë në zbatim dhe integritetit të subjekteve të përfshira. Në këtë kuadër, për të shmangur varësinë e plotë nga subjektet mbështetëse dhe për të siguruar një nivel minimal kapaciteti nga vetë ofertuesi, është parashikuar që ai duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor për të cilat kërkon të mbështetet.

Vendosja e një pragu të tillë (pra plotësimi i të paktën 50% të kërkesave të parashikuara nga AK) në vetvete synon që të balancojë nga njëra anë, të drejtën e Operatorit ekonomik për t'u mbështetur në kapacitetet e subjekteve të tjera duke zgjeruar në këtë mënyrë mundësinë e pjesëmarrjes në procedurën e prokurimit si nga ana tjetër, nevojën që Operatori ekonomik ofertues të zotërojë vetë një nivel të mjaftueshëm kapaciteti. Në këtë mënyrë Autoriteti Kontraktor merr garancinë e nevojshme dhe të domosdoshme se oferta e paraqitur nga ky Operator ekonomik është serioze si dhe pasqyron aftësinë reale të tij me qëllim zbatimin e kontratës me sukses.

Në këtë kuadër, përcaktimi i pragut minimal prej 50% shërben për të shmangur situatat kur Operatori ekonomik bëhet thjesht një ndërmjetës formal, i cili mbështetet pothuajse tërësisht tek subjektet e tjera, duke cënuar kështu parimet e përgjegjshmërisë, besueshmërisë dhe barazisë në gatë.

Ndodhur në këto kushte, Operatori ekonomik “GAMMA” shpk, në cilësinë e një OE ofertues që mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ka detyrimin ligjor të provojë se përmbush minimalisht 50% të kërkesave të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor, konkretisht në lidhje me kapacitetin teknik, pika 1 të implemetuar në DT.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se ky Operator është mbështetur në masën 51% në kapacitetet e subjektit mbështetës “SoLed” shpk, duke tejkaluar kështu kufirin e lejueshëm të mbështetjes dhe, duke mos garantuar përmbushjen e nivelit minimal të kërkuar nga vetë Operatori ekonomik ofertues.

Në këto rrethana, dhe në referim të të dhënave të deklaruara sipas Shtojcës 10, konstatohet se OE ankomes përmbush vetëm 49% të kërkesës së përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor në

lidhje me përvojën e mëpparshme të ngjashme, çka bie ndesh drejtëpërdrejtë me detyrimin ligjor për përmbushjen e të paktën 50% të kapacitetit përkatës. Për rrjedhojë, KSHA vlerëson se ankimuesi nuk ka arritur të provojë në mënyrë të mjaftueshme dhe të besueshme përmbushjen e kapaciteteve minimale të kërkuara, duke e bërë ofertën e tij të papajtueshme me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe, si e tillë, të pavlefshme për kualifikim.

KSHA argumenton se mospërmbushja e pragut minimal në lidhje me mbështetjen në kapacitetet e subjekteve të tjera, nuk është një mangësi formale, por konsiderohet një mosplotësim material i kriterëve të kualifikimit, që cenon barazinë në garë si dhe sigurinë e realizimit të kontratës me sukses.

Gjithashtu nga përmbajtja e marrëveshjes së bashkëpunimit nuk rezulton se subjekti mbështetës do të marrë pjesë në ekzekutimin e kontratës objekt prokurimi, nuk rezulton të ketë marrë përsipër kryerjen e ndonjë pjese të furnizimit, nuk rezulton të veprojë si nënkontraktor dhe as të ketë ndonjë detyrim konkret që lidhet me realizimin e kontratës që do të lidhet me Autoritetin Kontraktor.

Në këto kushte, marrëveshja e paraqitur provon vetëm vënien në dispozicion të dokumentacionit që dëshmon përvojën e mëparshme të subjektit mbështetës, por nuk provon vënien në dispozicion të vetë kapacitetit teknik dhe profesional që ka gjeneruar këtë përvojë.

KSHA gjykon se qëllimi i Nenit 90 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), nuk është të lejojë transferimin formal të dokumenteve kualifikuese midis Operatorëve ekonomike, por të garantojë që Operatori ekonomik ofertues do të ketë në dispozicion gjatë zbatimit të kontratës burimet, aftësitë dhe kapacitetet e nevojshme mbi të cilat është mbështetur për t’u kualifikuar.

Për sa kohë që nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur nuk është provuar përfshirja konkrete e subjektit mbështetës në realizimin e furnizimeve objekt kontrate dhe nuk është përcaktuar asnjë detyrim i tij gjatë fazës së ekzekutimit të kontratës, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, vlerëson se Operatori ekonomik “GAMMA” shpk nuk ka provuar në mënyrë të mjaftueshme se do të ketë realisht në dispozicion kapacitetet teknike dhe profesionale të deklaruar, sipas kërkesave të Nenit

90 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

Për rrjedhojë, KSHA gjykon se dokumentacioni i paraqitur nga Operatori ekonomik “GAMMA” shpk nuk konsiderohet i mjaftueshëm për të vërtetuar përmbushjen e kriterit të përvojës së ngjashme nëpërmjet mbështetjes në kapacitetet e subjektit tjetër.

Për sa më sipër, pretendimi i Bashkimit të Operatorëve ekonomikë ankimues qëndron.

II.2. Lidhur me pretendimin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë ankimues “O.E.S DISTRIMED” shpk & “EUROMED” shpk mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga OE “GAMMA” shpk ku argumentohet se: Të verifikohet në mënyrë të detajuar qdo qertifikim CE (nën rregulloren MDR) për të gjitha materialet e ofertuara nga OE GAMMA në plotësim të kriteve teknike dhe kualifikuese ose nëse janë paraqitur flertifikata MDD...”, KSHA arsyeton se:

.... Referuar dokumenteve të tenderit të publikuara për procedurën e prokurimit objekt ankimi, konstatohet se në përmbushje të kërkesave teknike ndër të tjera është pamshikuar dhe paraqitja e Certifikatave të konformiteti CE ose FDA / deklarate konformiteti CE ose FDA (aty ku është e aplikueshme), për të gjithë artikujt e ofruar sipas kategorizimit të tyre nga Ofertuesit.

Ndodhur në kushtet ku objekti i prokurimit lidhet drejtpërdrejtë me furnizimin e materialeve të mjekimit konsumabël dhe materialeve kirurgjikale, kërkesa për paraqitjen e certifikatës ose deklaratës së konformitetit CE (ose FDA, sipas rastit) është e lidhur ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit. Markimi CO përbën provë se produktet përmbushin kërkesat thelbësore të sigurisë, cilësisë dhe performancës, të përcaktuara nga legjislacioni i Bashkimit Evropian për pajisjet mjekësore.

Rëndësia e këtij dokumentacioni bëhet edhe më e madhe për shkak se mallrat e prokuruar do të përdoren në ofrimin e shërbimit shëndetësor dhe do të kenë kontakt të drejtpërdrejtë me pacientët.

Për rrjedhojë, Autoriteti Kontraktor ka interes të ligjshëm të verifikojë që produktet e ofruara janë të certifikuara sipas standardeve të njohura ndërkombëtare dhe garantojnë nivelin e kërkuar të sigurisë dhe efektivitetit gjatë përdorimit të tyre në institucionet shëndetësore.

Nisur nga pretendimi i Bashkimit të Operatorëve ekonomik ankimes, KSHA pasi mori në shqyrtim dokumentacionin e paraqitur nga Operatori ekonomik "GAMMA" shpk konstatoi se ky i fundit nuk ka paraqitur Certifikatë konformiteti CE ose FDA / deklarate konformiteti CE ose FDA për artikujt me Nr. 53; Nr. 54; Nr. 55 si dhe me Nr. 56 nga Prodhuesi JOST.

Gjithashtu në lidhje me artikujt e sipërcituar konstatohet se Operatori ekonomik nuk ka paraqitur Autorizim nga prodhuesi ku të provohet lidhja me katalogun e Prodhuesit JOST.

Duke qenë se objekti i prokurimit lidhet me furnizimin e materialeve mjekësore konsumabël dhe kirurgjikale, paraqitja e certifikatave CE/MDD dhe deklaratave të konformitetit merr një rëndësi të veçantë, pasi këto dokumente vërtetojnë se produktet përmbushin kërkesat thelbësore të sigurisë dhe cilësisë të përcaktuara nga legjislacioni përkatës për pajisjet mjekësore.

Referuar katalogut të paraqitur në SPE nga Operatori ekonomik "GAMMA" shpk për artikujt me Nr. 46, Nr. 47, Nr. 48, Nr. 49, Nr. 50, Nr. 51 si dhe Nr. 52 nga prodhuesi ORION, për të cilët ka paraqitur CertifikatëN CE me Nr. 2020-MDD/QS-029 me afat vlefshmërie 26.05.2024 në të cilën përcaktohet se këto artikuj i përkasin klasës III të riskut.

OE "GAMMA" shpk ka paraqitur dokumentin "Notified Body Confirmation Letter" me Nr. Ref MIT/2024/P104 lëshuar nga Enti certifikues 3EC International ku në tabelën 1 pajisjet e mbuluara nga ky dokument dhe për të cilat organi certifikues është përgjegjës për mbikqyjen e pajisjeve përkatëse, rezulton se këto artikuj janë nën përgjegjësinë e Entit certifikues DGPS. Në këtë dokument, "Notified Body Confirmation Letter", faqe Nr. 134, Enti Certifikues 3EC International ka sqaruar se artikujt "Sterile Absorbable Surgical Suture", i përksin Klasës III dhe mbulohen nga dy Certifikata, nga Certifikata me Nr. 2020-MDD/QS-029 dhe Certifikata me Nr. 2020-MDD/DE-030, e cila nuk është paraqitur nga OE "GAMMA" shpk.

Sa me lart cituar, KSHA vlerëson se OE "GAMMA" SHPK nuk ka dorëzuar të gjithë dokumentacionin CE sipas përcaktimeve nga Enti Certifikues për artikujt Nr. 46,47,48,49,50,51,52.

Gjithashtu, referuar katalogut të dorëzuar nga operatori ekonomik GAMMA, KSHA konstaton se operatori ka ofruar nga Prodhuesi "SURU INTERNATIONAL PVT LTD" për të cilët la

paraqitur Certifikatën CE me nr. 10000322032-PA-NA-IND Rev 0.0 ma afat vlefshmërie 27 Maj 2024 në të cilën përcaktohet se artikujt Nr. 8 dhe Nr. 9 i përkasin Klasës III të riskut. OE “GAMMA” SHPK ka paraqitur dokumentin “Notified Body Confirmation Letter” me numër reference 1000180250 lëshuar nga Enti Certifikues DQS ku në tabelën 1 “Table 1: Devices covered by this letter and for which the NB is also responsible for appropriate surveillance of the corresponding devices under the applicable Directive / Tabela 1: Pajisjet e mbuluara nga kjo letër dhe për të cilat NB (Organi i Njoftuar) është gjithashtu përgjegjës për mbikëqyjen e duhur të pajisjeve përkatëse sipas Direktivës në fuqi” ku rezulton se keta dy artikuj janë nën përgjegjësinë e Entit Certifikues DQS. Në këtë dokument, Enti Certifikues DQS ka sqaruar se artikujt Age Spirale, i përkasin Klasës III dhe mbulohen nga dy Certifikata, nga Certifikata me nr.10000322032-PA-NA-IND Rev 0.0 dhe Certifikata me nr. 10000322038-PA-NA-IND v 0.0 cila nuk është paraqitur nga OE “GAMMA” shpk.

KSHA vlerëson se OE “GAMMA” shpk nuk ka dorëzuar të gjithë dokumentacionin CO sipas përcaktimeve nga Enti Certifikues për artikujt Nr. 8 dhe Nr. 9.

Në përfundim, KSHA vlerëson se dokumentacioni i paraqitur nga Operatori ekonomik “GAMMA” shpk nuk provon përmbushjen e kërkesave teknike të vendosura nga Autoriteti Kontraktor, pasi certifikatat dhe deklaratat e konformitetit si dhe autorizimet e prodhuesit përbëjnë dokumentacionin përkatës provues që garanton përputhshmërinë e produkteve me standardet e kërkuara të cilësisë, sigurisë dhe performancës.

Për sa më sipër, pretendimi i Bashkimit të Operatorëve ekonomikë ankimues qëndron.....”

II.9. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 10.06.2026 nëpërmjet shërbimit postar pranë Komisionit të Prokurimit Publik është depozituar shkresa e operatorit ekonomik “GAMMA” SHPK nr.70101 prot., datë 09.06.2026 me objekt “Mbi vendimin e KSHA –së për pranimin e pjesshëm të ankesës së BOE “O.E.S DISTRIMED” SHPK & “EUROMED” SHPK dhe vendimin për skualifikimin e ofertës tonë”, për procedurën e prokurimit nëpërmjet së cilës kundërshton vendimmarrjen e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës për skualifikimin e operatorit ekonomik “GAMMA” SHPK, si rrjedhojë e shqyrtimit nga KSHA të ankesës me nr. A/2026/6592 datë 21.05.2026 dhe me nr.1587 prot., datë 21.05.2026 të BOE “O.E.S DISTRIMED” SHPK & “EUROMED” SHPK.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor dhe verifikimeve të kryera,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e BOE “O.E.S DISTRIMED” SHPK & “EUROMED” SHPK mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “GAMMA” SHPK në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi për mospërbushje nga ana e këtij të kritereve dhe specifikimeve teknike, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Nëpërmjet shkresës nr.832/23 prot, datë 03.06.2026, protokolluar me tonën me nr. 1587/3 prot, datë 04.06.2026 (ardhur nëpërmjet sistemit elektronik), dhe me nr. 1587/4 prot, datë 04.06.2026 (ardhur nëpërmjet shërbimit postar) është depozituar nga autoriteti kontraktor akti i trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues (vendimi i KSHA-së) nga ku rezulton se autoriteti kontraktor ka vendosur pranimin e pjesshëm të ankesës së operatorit ekonomik ekonomik BOE “O.E.S DISTRIMED” SHPK & “EUROMED” SHPK dhe konkretisht :

“...Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, pasi mori në shqyrtim dokumentacionin e paraqitur në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga Operatori ekonomik “GAMMA” shpk, konstatoi se për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, rezulton se OE ka paraqitur faturat përkatëse tatimore të shitjes:

- *Fatura Nr. 22 me vlerë 1,079,020 lekë pa TVSH lëshuar datë 26.02.2025;*
Fatura Nr. 41 me vlerë 446,679 lekë pa TVSH lëshuar më datë 24.03.2025;
- *Fatura Nr. 97 me vlerë 115,365.60 lekë pa TVSH lëshuar më datë 10.06.2025;*
- *Fatura Nr. 252 me vlerë 764,359 lekë pa TVSH lëshuar më datë 09.07.2024;*
- *Fatura Nr. 24 me vlerë 2,063,301 lekë pa TVSH lëshuar më datë 28.02.2025;*
- *Fatura Nr. 251 me vlerë 2,219,307 lekë pa TVSH lëshuar më datë 03.07.2024;*
- *Fatura Nr. 3 me vlerë 1,813,340 lekë pa TVSH lëshuar më datë 11.01.2023;*
- *Fatura Nr. 316 me vlerë 970,000 lekë pa TVSH lëshuar më datë 14.10.2024;*
- *Fatura Nr. 89 me vlerë 975,000 lekë pa TVSH lëshuar më datë 04.06.2025;*
- *Fatura Nr. 5 me vlerë 356,140 lekë pa TVSH lëshuar më datë 18.03.2025.*

Nga shqyrtimi i këtyre faturave konstatohet se përmbushja e kërkesës së përcaktuar sipas kapacitetit teknik për p'ërvojën e mëparshme të ngjashme në të trija aspektet e saj, konkretisht ngjashmërinë me objektin e procedurës së prokurimit, vlerën e përllogaritur si dhe afatin kohor për ekzekutimin e furnizimeve, plotësohet nga Faturat me Nr. 316 dhe me Nr. 89.

Referuar Faturave me Nr. 97, me Nr. 24, me Nr. 41, me Nr. 5 si dhe me Nr. 252 evidentohet se artikujt objekt të faturave nuk janë të ngjashëm me artikujt objekt të procedurës së prokurimit e si r edhojë këto fatura nuk do të përllogariten në totalin e shumatores së dëshmime U ngjashme.

Ndërsa në lidhje me Faturën Nr. 3, e cila daton më 11.01.2023, qartazi evidentohet se nuk është realizuar gjatë 3 (tri) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës (theksojmë se njoftimi kontratës daton më 25.02.2026). Për këtë arsye kjo faturë nuk do të përllogaritet në totalin e shumatores së dëshmime të ngjashme.

Nga shqyrtimi i Faturës me Nr. 22 konstatohet se vlera e artikujve të ngjashëm me objektin e prokurimit është 435,408 lekë pa TVSH;

Nga shqyrtimi i Faturës me Nr. 251 konstatohet se vlera e artikujve të ngjashëm me objektin e prokurimit është 759,708 lekë pa TVSH.

Nga sa më lart cituar, konstatohet se vlera e përlllogaritur e faturave të vlefshme të paraqitura, të cilat konsiderohen të ngjashme me objektin e prokurimit konsiston në vlerën totale prej 3,140,116 lekë pa TVSH.

Pra, Operatori ekonomik “GAMMA” shpk nëpërmjet faturave të paraqitura në S.P.E nuk arrin të provojë përvojën e ngjashme të realizuar gjatë 3 (tri) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, pasi vlera e faturave të përlllogaritura nuk arrin masën e përcaktuar në DT, konkretisht 39 % e vlerës së fondit limit.

Në lidhje me pretendimin e ankimuesit ku argumentohet se: Në rast se OE GAMMA është mbështetur në kapacitetet e ndonjë OE tjetër, kërkojmë që të verifikohet nëse është deklaruar përqindja e mbështetjes Conform VKM Nr. 285 datë 19.05.2021, Neni 90, pika 2, në mënyrë që vlerësimi të bëhet Conform përqindjes së deklaruar, pasi mbështetja në kapacitetet e një operatori tjetër është e limituar deri në maksimumi 50 % dhe një gjë e tillë duhet të deMarohet saktësisht në Shtojcën 9 sid e parashikon VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, Neni 90, pika 2. ... ”,
KSHA

Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit të publikuara për procedurën e prokurimit objekt ankimi, KSHA konstaton se Autoriteti Kontraktor, OBP sha, në pikën 2.16 të Seksionit 2 të DT ka lejuar Operatorët ekonomikë ofertues që të mbështeten në kapacitetet e subjekteve të tjera. Gjithashtu Në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, Pjesa I, në Seksionin përkatës në pikën B “Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin e të cilëve do të mbështetët operatori ekonomik” OE ka deklaruar si subjekt mbështetës shoqërinë “SoLed” shpk për përmbushjen e kërkesës mbi përvojën e ngjashme.

Në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Kreu XI, Neni 90, pika 4 është parashikuar se: “4. Në qdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti Kontraktor.”

E drejta e operatorit ekonomik për t'u mbështetur në kapacitetet e subjekteve të tjera është e njohur dhe e garantuar nga legjislacioni i prokurimit publik, si një instrument që synon të nxisë konkurrencën dhe të zgjerojë pjesëmarrjen në procedurat e prokurimit. Nëpërmjet kësaj të drejte, Operatori ekonomik mund të përdorë burimet dhe aftësitë e subjekteve mbështetëse për të përmbushur kërkesat e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor, pavarësisht natyrës juridike të marrëdhënies ndërmjet tyre. Ushtrimi i kësaj të drejte nuk është absolut, por i nënshtrohet kushteve dhe kufizimeve të përcaktuara në ligj dhe në dokumentet e tenderit, me qëllim garantimin e seriozitetit të ofertës, përgjegjshmërisë në zbatim dhe integritetit të subjekteve të përfshira. Në këtë kuadër, për të shmangur varësinë e plotë nga subjektet mbështetëse dhe për të siguruar një nivel minimal kapaciteti nga vetë ofertuesi, është parashikuar që ai duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor për të cilat kërkon të mbështetet.

Vendosja e një pragu të tillë (pra plotësimi i të paktën 50% të kërkesave të parashikuara nga AK) në vetvete synon që të balancojë nga njëra anë, të drejtën e Operatorit ekonomik për t'u mbështetur në kapacitetet e subjekteve të tjera duke zgjeruar në këtë mënyrë mundësinë e pjesëmarrjes në procedurën e prokurimit si nga ana tjetër, nevojën që Operatori ekonomik ofertues të zotërojë vetë një nivel të mjaftueshëm kapaciteti. Në këtë mënyrë Autoriteti Kontraktor merr garancinë e nevojshme dhe të domosdoshme se oferta e paraqitur nga ky Operator ekonomik është serioze si dhe pasqyron aftësinë reale të tij me qëllim zbatimin e kontratës me sukses.

Në këtë kuadër, përcaktimi i pragut minimal prej 50% shërben për të shmangur situatat kur Operatori ekonomik bëhet thjesht një ndërmjetës formal, i cili mbështetet pothuajse tërësisht tek subjektet e tjera, duke cënuar kështu parimet e përgjegjshmërisë, besueshmërisë dhe barazisë në gatë.

Ndodhur në këto kushte, Operatori ekonomik "GAMMA" shpk, në cilësinë e një OE ofertues që mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ka detyrimin ligjor të provojë se përmbush minimalisht 50% të kërkesave të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor, konkretisht në lidhje me kapacitetin teknik, pika 1 të implemetuar në DT.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se ky Operator është mbështetur në masën 51% në kapacitetet e subjektit mbështetës "SoLed" shpk, duke tejkaluar kështu kufirin e lejueshëm të mbështetjes dhe, duke mos garantuar përmbushjen e nivelit minimal të kërkuar nga vetë Operatori ekonomik ofertues.

Në këto rrethana, dhe në referim të të dhënave të deklaruara sipas Shtojcës 10, konstatohet se OE ankomes përmbush vetëm 49% të kërkesës së përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor në lidhje me përvojën e mëpparshme të ngjashme, çka bie ndesh drejtëpërdrejtë me detyrimin ligjor për përmbushjen e të paktën 50% të kapacitetit përkatës. Për rrjedhojë, KSHA vlerëson se ankimuesi nuk ka arritur të provojë në mënyrë të mjaftueshme dhe të besueshme përmbushjen e kapaciteteve minimale të kërkuara, duke e bërë ofertën e tij të papajtueshme me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe, si e tillë, të pavlefshme për kualifikim.

KSHA argumenton se mospërmbushja e pragut minimal në lidhje me mbështetjen në kapacitetet e subjekteve të tjera, nuk është një mangësi formale, por konsiderohet një mosplotësim material i kriterëve të kualifikimit, që cenon barazinë në garë si dhe sigurinë e realizimit të kontratës me sukses.

Gjithashtu nga përmbajtja e marrëveshjes së bashkëpunimit nuk rezulton se subjekti mbështetës do të marrë pjesë në ekzekutimin e kontratës objekt prokurimi, nuk rezulton të ketë marrë përsipër kryerjen e ndonjë pjese të fëmizimit, nuk rezulton të veprojë si nënkontraktor dhe as të ketë ndonjë detyrim konkret që lidhet me realizimin e kontratës që do të lidhet me Autoritetin Kontraktor.

Në këto kushte, marrëveshja e paraqitur provon vetëm vënien në dispozicion të dokumentacionit që dëshmon përvojën e mëparshme të subjektit mbështetës, por nuk provon vënien në dispozicion të vetë kapacitetit teknik dhe profesional që ka gjeneruar këtë përvojë.

KSHA gjykon se qëllimi i Nenit 90 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar), nuk është të lejojë transferimin formal të dokumenteve kualifikuese midis Operatorëve ekonomike, por të garantojë që Operatori ekonomik ofertues do

të ketë në dispozicion gjatë zbatimit të kontratës burimet, aftësitë dhe kapacitetet e nevojshme mbi të cilat është mbështetur për t'u kualifikuar.

Për sa kohë që nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur nuk është provuar përfshirja konkrete e subjektit mbështetës në realizimin e furnizimeve objekt kontrate dhe nuk është përcaktuar asnjë detyrim i tij gjatë fazës së ekzekutimit të kontratës, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, vlerëson se Operatori ekonomik "GAMMA" shpk nuk ka provuar në mënyrë të mjaftueshme se do të ketë realisht në dispozicion kapacitetet teknike dhe profesionale të deklaruar, sipas kërkesave të Nenit

90 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për mimtimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar).

Për rrjedhojë, KSHA gjykon se dokumentacioni i paraqitur nga Operatori ekonomik "GAMMA" shpk nuk konsiderohet i mjaftueshëm për të vërtetuar përmbushjen e kriterit të përvojës së ngjashme nëpërmjet mbështetjes në kapacitetet e subjektit tjetër.

Për sa më sipër, pretendimi i Bashkimit të Operatorëve ekonomikë ankimues qëndron.

II.2. Lidhur me pretendimin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë ankimues "O.E.S DISTRIMED" shpk & "EUROMED" shpk mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga OE "GAMMA" shpk ku argumentohet se: Të verifikohet në mënyrë të detajuar qdo qertifikim CE (nën rregulloren MDR) për të gjitha malerialët e ofertuar nga OE GAMMA në plotësim të kriteve teknike dhe kualifikuese ose nëse janë paraqitur flertifikata MDD... ", KSHA arsyeton se:

.... Referuar dokumenteve të tenderit të publikuara për procedurën e prokurimit objekt ankimi, konstatohet se në përmbushje të kërkesave teknike ndër të tjera është pamshikuar dhe paraqitja e Certifikatave të konformiteti CE ose FDA / deklarate konformiteti CE ose FDA (aty ku eshte e aplikueshme), për të gjithë artikujt e ofruar sipas kategorizimit të tyre nga Ofertuesit.

Ndodhur në kushtet ku objekti i prokurimit lidhet drejtpërdrejtë me furnizimin e materialeve të mjekimit konsumabël dhe materialeve kirurgjikale, kërkesa për paraqitjen e certifikatës ose deklaratës së konformitetit CE (ose FDA, sipas rastit) është e lidhur ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit. Markimi CO përbën provë se produktet përmbushin kërkesat thelbësore të sigurisë, cilësisë dhe performancës, të përcaktuara nga legjislacioni i Bashkimit Evropian për pajisjet mjekësore.

Rëndësia e këtij dokumentacioni bëhet edhe më e madhe për shkak se mallrat e prokuruar do të përdoren në ofrimin e shërbimit shëndetësor dhe do të kenë kontakt të drejtpërdrejtë me pacientët.

Për rrjedhojë, Autoriteti Kontraktor ka interes të ligjshëm të verifikojë që produktet e ofruara janë të certifikuara sipas standardeve të njohura ndërkombëtare dhe garantojnë nivelin e kërkuar të sigurisë dhe efektivitetit gjatë përdorimit të tyre në institucionet shëndetësore.

Nisur nga pretendimi i Bashkimit të Operatorëve ekonomik ankimues, KSHA pasi mori në shqyrtim dokumentacionin e paraqitur nga Operatori ekonomik "GAMMA" shpk konstatoi se ky i fundit nuk ka paraqitur Certifikatë konformiteti CE ose FDA / deklarate konformiteti CE ose FDA për artikujt me Nr. 53; Nr. 54; Nr. 55 si dhe me Nr. 56 nga Prodhuksi JOST.

Gjithashtu në lidhje me artikujt e sipërcituar konstatohet se Operatori ekonomik nuk ka paraqitur Autorizim nga prodhuesi ku të provohet lidhja me katalogun e Prodhuesit JOST.

Duke qenë se objekti i prokurimit lidhet me fumizimin e materialeve mjekësore konsumabël dhe kirurgjikale, paraqitja e certifikatave CE/MDD dhe deklaratave të konformitetit merr një rëndësi të veçantë, pasi këto dokumente vërtetojnë se produktet përmbushin kërkesat thelbësore të sigurisë dhe cilësisë të përcaktuara nga legjislacioni përkatës për pajisjet mjekësore.

Referuar katalogut të paraqitur në SPE nga Operatori ekonomik “GAMMA” shpk për artikujt me Nr. 46, Nr. 47, Nr. 48, Nr. 49, Nr. 50, Nr. 51 si dhe Nr. 52 nga prodhuesi ORION, për të cilët ka paraqitur CertifikatëN CE me Nr. 2020-MDD/QS-029 me afat vlefshmërie 26.05.2024 në të cilën përcaktohet se këto artikuj i përkasin klasës III të riskut.

OE “GAMMA” shpk ka paraqitur dokumentin “Notified Body Confirmation Letter” me Nr. Ref MIT/2024/P104 lëshuar nga Enti certifikues 3EC International ku në tabelën 1 pajisjet e mbuluara nga ky dokument dhe për të cilat organi certifikues është përgjegjës për mbikqyjen e pajisjeve përkatëse, rezulton se këto artikuj janë nën përgjegjësinë e Entit certifikues DGPS. Në këtë dokument, “Notified Body Confirmation Letter”, faqe Nr. 134, Enti Certifikues 3EC International ka sqaruar se artikujt “Sterile Absorbable Surgical Suture”, i përkasin Klasës III dhe mbulohen nga dy Certifikata, nga Certifikata me Nr. 2020-MDD/QS-029 dhe Certifikata me Nr. 2020-MDD/DE-030, e cila nuk është paraqitur nga OE “GAMMA” shpk.

Sa me lart cituar, KSHA vlerëson se OE “GAMMA” SHPK nuk ka dorëzuar të gjithë dokumentacionin CE sipas përcaktimeve nga Enti Certifikues për artikujt Nr. 46,47,48,49,50,51,52.

Gjithashtu, referuar katalogut të dorëzuar nga operatori ekonomik GAMMA, KSHA konstaton se operatori ka ofeHuar nga Prodhuesi “SURU INTERNATIONAL PVT LTD” për të cilët la paraqitur Certifikatën CE me nr. 10000322032-PA-NA-IND Rev 0.0 ma afat vlefshmërie 27 Maj 2024 në të cilën përcaktohet se artikujt Nr. 8 dhe Nr. 9 i përkasin Klasës III të riskut. OE “GAMMA” SHPK ka paraqitur dokumentin “Notified Body Confirmation Letter” me numër reference 1000180250 lëshuar nga Enti Certifikues DQS ku në tabelën 1 “Table 1: Devices covered by this letter and for which the NB is also responsible for appropriate surveillance of the corresponding devices under the applicable Directive / Tabela 1: Pajisjet e mbuluara nga kjo letër dhe për të cilat NB (Organi i Njoftuar) është gjithashtu përgjegjës për mbikëqyjen e duhur të pajisjeve përkatëse sipas Direktivës në fuqi” ku rezulton se keta dy artikuj janë nën përgjegjësinë e Entit Certifikues DQS. Në këtë dokument, Enti Certifikues DQS ka sqaruar se artikujt Age Spirale, i përkasin Klasës III dhe mbulohen nga dy Certifikata, nga Certifikata me nr.10000322032-PA-NA-IND Rev 0.0 dhe Certifikata me nr. 10000322038-PA-NA-IND v 0.0 cila nuk është paraqitur nga OE “GAMMA” shpk.

KSHA vlerëson se OE “GAMMA” shpk nuk ka dorëzuar të gjithë dokumentacionin CO sipas përcaktimeve nga Enti Certifikues për artikujt Nr. 8 dhe Nr. 9.

Në përfundim, KSHA vlerëson se dokumentacioni i paraqitur nga Operatori ekonomik “GAMMA” shpk nuk provon përmbushjen e kërkesave teknike të vendosura nga Autoriteti Kontraktor, pasi pertifikatat dhe deklaratat e konformitetit si dhe autorizimet e prodhuesit përbëjnë dokumentacionin përkatës provues që garanton përputhshmërinë e produkteve me standardet e kërkuara të cilësisë, sigurisë dhe performancës.

Për sa më sipër, pretendimi i Bashkimit të Operatorëve ekonomikë ankimues qëndron.....”.

III.1.2. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 10.06.2026 nëpërmjet shërbimit postar pranë Komisionit të Prokurimit Publik është depozituar shkresa e operatorit ekonomik “GAMMA” SHPK nr.70101 prot., datë 09.06.2026 me objekt “Mbi vendimin e KSHA –së për pranimin e pjesshëm të ankesës së BOE “O.E.S DISTRIMED” SHPK & “EUROMED” SHPK dhe vendimin për skualifikimin e ofertës tonë”, për procedurën e prokurimit nëpërmjet së cilës kundërshton vendimmarrjen e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës për skualifikimin e operatorit ekonomik “GAMMA” SHPK, si rrjedhojë e shqyrtimit nga KSHA të ankesës me nr. A/2026/6592 datë 21.05.2026 dhe me nr.1587 prot., datë 21.05.2026 të BOE “O.E.S DISTRIMED” SHPK & “EUROMED” SHPK

III.1.3. Neni 30 i LPP-së, parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.*

III.1.4. Neni 114 i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se:

“1. Në rastet e ankesave për dokumentet e tenderit, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet në lidhje me ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga momenti i konfirmimit të regjistrimit të saj nga Komisioni i Prokurimit Publik. Në rastet e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet për ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit kohor në dispozicion të operatorëve ekonomikë të interesuar, sipas parashikimeve në nenin 113 të këtij ligji, për paraqitjen e argumenteve të tyre.

2. Në rastin kur për shqyrtimin e ankesës autoriteti ose enti kontraktor ka nevojë të kryejë verifikime pranë organeve të tjera, afati i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni ndërpritet dhe rifillon pasi të ketë siguruar informacionin e kërkuar. Në çdo rast, për pritjen e informacionit të kërkuar afati nuk duhet të tejkalojë 30 ditë.

Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të vërë menjëherë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin dhe operatorët ekonomikë të interesuar për zgjatjen e afatit.

3. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës sipas parashikimeve në këtë nen, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë:

- a) pranimin e plotë të ankesës;*
- b) pranimin e pjesshëm të ankesës;*
- c) refuzimin e ankesës.*

4. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të

punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.

5. Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit nga autoriteti ose enti kontraktor, sipas pikës 4 të këtij neni.

6. Nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur ankesë sipas pikës 5 të këtij neni, ata nuk do të kenë të drejtë të paraqesin më pas një ankesë për veprimet e autoritetit ose entit kontraktor, të kryera në zbatim të vendimit të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik.

III.1.5. Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i cili parashikon shprehimisht se : “1. Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.

III.1.6. Para shqyrtimit në themel të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, Komisioni referuar kronologjisë së fakteve të parashtruara më sipër, si dhe referuar bazës ligjore të sipërcituar gjen me vend të sqarojë dy momente tepër të rëndësishme, si mbi interesin e ligjshëm

të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në kuptim të ligjit aktual në fuqi, ashtu edhe të së drejtës së tyre për të ushtruar të drejtën e ankimit për skualifikimin e ofertës së tyre nga veprimet e autoritetit kontraktor dhe për kualifikimin e operatorëve të tjerë ekonomikë në procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

III.1.7 Bazuar në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenin 110 dhe 113 “Të drejtat e operatorëve ekonomik të interesuar”, parashikohet se:

“1. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë. 2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë”.

III.1.8. Në nenin 113 parashikohet se: *“1. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, afati kohor për paraqitjen e këtyre argumenteve është 7 ditë nga publikimi i ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 5 ditë. Paraqitja e argumenteve bëhet në Sistemin e Ankesave Elektronike.*

2. Nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumente që kundërshtojnë ankesën, sipas parashikimeve të pikës 1 të këtij neni, nuk mund të ushtrojnë më pas të drejtën e ankimit për vendimin e dhënë në lidhje me ankesën për këtë procedurë prokurimi.”,

III.1.9. Në nenin 113 parashikohet se *“1. Në rastet e ankesave për dokumentet e tenderit, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet në lidhje me ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga momenti i konfirmimit të regjistrimit të saj nga Komisioni i Prokurimit Publik.*

Në rastet e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet për ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit kohor në dispozicion të operatorëve ekonomikë të interesuar, sipas parashikimeve në nenin 113 të këtij ligji, për paraqitjen e argumenteve të tyre.

2. Në rastin kur për shqyrtimin e ankesës autoriteti ose enti kontraktor ka nevojë të kryejë verifikime pranë organeve të tjera, afati i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni ndërpritet dhe rifillon pasi të ketë siguruar informacionin e kërkuar. Në çdo rast, për pritjen e informacionit të kërkuar afati nuk duhet të tejkalojë 30 ditë.

Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të vërë menjëherë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin dhe operatorët ekonomikë të interesuar për zgjatjen e afatit.

3. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës sipas parashikimeve në këtë nen, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë:

- a) pranimin e plotë të ankesës;
- b) pranimin e pjesshëm të ankesës;
- c) refuzimin e ankesës.

4. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.

5. Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik brenda 7 ditëve nga marrja e njoftimit nga autoriteti ose enti kontraktor për procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar dhe brenda 10 ditëve për procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, sipas pikës 4 të këtij neni.

6. Nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur ankesë sipas pikës 5 të këtij neni, ata nuk do të kenë të drejtë të paraqesin më pas një ankesë për veprimet e autoritetit ose entit kontraktor, të kryera në zbatim të vendimit të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik.

III.1.10. Referuar materialeve të administruara në fashikullin e shqyrtimit administrativ, KPP konstaton, se fillimisht në datën 07.05.2026 autoriteti kontraktor ka vlerësuar ofertat e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës dhe më pas në datën 13.05.2026 ka publikuar njoftimin e fituesit për procedurën objekt ankimi. Në datën 21.05.2026 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar me numër ankimimi nr. A/2026/6592 datë 21.05.2026 dhe me nr.1587 prot., datë 21.05.2026 e BOE “O.E.S DISTRIMED” SHPK & “EUROMED” SHPK, ku u konstatua, se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimmarrjes së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “GAMMA” SHPK. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit 1587/1 prot., datë 21.05.2026.

Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, në datën 25.05.2026 pranë Komisionit Prokurimit Publik është protokolluar me shkresën nr. 1587/2 prot “Formulari i Paraqitjes së Argumentave nga Operatori Ekonomik i Interesuar “GAMMA” SHPK”, në përputhje me nenin 113 të ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik BOE “O.E.S DISTRIMED” SHPK & “EUROMED” SHPK lidhur me kualifikimin e operatorit ekonomik “GAMMA” SHPK.”.

Referuar nenit 113 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku subjektet që mund të cenohen nga ankesa e paraqitur kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me ankesat e operatorëve të tjerë, duke përmbushur 3 kushte kumulative: 1. Të cenohen nga ankesa e paraqitur (në rastin konkret është ankesa e BOE “O.E.S DISTRIMED” SHPK & “EUROMED” SHPK) 2. Kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit (ankesën) njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik 3. Argumentet të paraqiten në përputhje me afatet kohore dhe mënyrën e paraqitjes të përcaktuara në nenin 113 të ligjit për prokurimin publik.

Nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumente që kundërshtojnë ankesën, sipas parashikimeve të pikës 1 të këtij neni, nuk mund të ushtrojnë më pas të drejtën e ankimit për vendimin e dhënë në lidhje me ankesën për këtë procedurë prokurimi. Pra, sistemi i ankimit njeh të drejtën e ankimit një herë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoriteteve kontraktore, në rast se operatorët ekonomikë gjykojnë, se për shkak të vendimmarrjes së autoritetit kontraktor mund të cenohen të drejtat e tyre. Ndërkohë, ligjvënësi ka parashikuar edhe të drejtat e subjektit të interesuar në procedurën e prokurimit në përputhje me nenin 113 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Në nenin 114 të LPP-së, parashikohet shprehimisht, se *“Në rastet e ankesave për dokumentet e tenderit, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet në lidhje me ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga momenti i konfirmimit të regjistrimit të saj nga Komisioni i Prokurimit Publik. Në rastet e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet për ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit kohor në dispozicion të operatorëve ekonomikë të interesuar, sipas parashikimeve në nenin 113 të këtij ligji, për paraqitjen e argumenteve të tyre. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës”.* Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, për procedurat nën kufirin e lartë monetar kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik brenda 7 ditëve nga marrja e njoftimit nga autoriteti ose enti kontraktor, sipas pikës 4 të këtij neni. Ndërsa në nenin 100 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, pika 4 dhe 5, parashikohet: *“4. Autoriteti/enti kontraktor merr vendim, sipas parashikimit të pikës 3, të nenit 114, të LPP-së, dhe vë në dijeni, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës. 5. Kundër vendimit të autoritetit/entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik, brenda 7 ditëve nga marrja e njoftimit nga autoriteti ose enti kontraktor, për procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar dhe brenda 10 ditëve për procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, sipas pikës 4, të këtij neni”.*

Komisioni i Prokurimit Publik, thekson faktin se përcaktimi i procedurave dhe afateve të caktuara procedurale në LLP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati për përgatitjen e ofertës, afati i shqyrtimit të ofertave, afati i ankimit etj, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga lex specialis LPP, në nenin 2 të tij, janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementeve të mësipërme lidhet ngushtësisht me elemente të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike. Gjithashtu, KPP gjykon, se ligjvënësi ka parashikuar afate strikte kohore për zhvillimin e

procedurave të prokurimit në përgjithësi dhe në veçanti në lidhje me institutin e ankimit administrativ, të rishikimit të vendimarrjes së autoritetit kontraktor. Sa më sipër, e drejta procedurale e njohur nga ligji për të paraqitur argumente kundër ankesës së operatorëve ekonomikë nga operatorët e tjerë ekonomikë të interesuar, lidhet ngushtësisht me paraqitjen e argumenteve mbi ankesën e dorëzuar nga këto të fundit në kuadër të rishikimit administrativ. Pra, subjektet e interesuara, në paraqitjen e argumenteve duhet të mbajnë në konsideratë, se e drejta procedurale e paraqitjes së argumenteve është e ndryshme nga e drejta e ankimit, pasi kemi të bëjmë me dy momente të ndryshme. E para, (argumenti) lidhet me faktin e kundështrimit të ankesës (paraqitjes së pretendimeve nga palët, se përse ankesa e paraqitur nuk duhet pranuar nga ana e autoritetit kontraktor/Komisionit të Prokurimit Publik), ndërkohë ankesa në thelb përbën një mjet juridik të kundërshtimit të vendimarrjes së autoritetit kontraktor për kualifikimin/skualifikimin e ofertës së operatorëve ekonomikë. Pra argumentet në thelb janë të kufizuara mbi ankesën e operatorit ekonomik.

Referuar materialeve të fashikullit administrativ, procedura objekt ankimi është procedurë mbi kufirin e lartë monetar, subjekti “GAMMA” SHPK, si subjekt që cënohej nga ankesa e operatorit ekonomik BOE “O.E.S DISTRIMED” SHPK & “EUROMED” SHPK me nr. 1587/2026 prot., datë 21.05.2026, referuar bazës ligjore të sipërcituar ka të drejtë të paraqes argumentet e tij në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik brenda 7 ditëve nga publikimi i ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik, argumenta të cilat duhet të paraqiten në Sistemin e Ankesave Elektronike. Referuar kronologjisë së fakteve, Komisioni konstaton se argumentet e paraqitura nga operatori ekonomik “GAMMA” SHPK në datë 25.05.2026 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, janë paraqitur në përputhje me parashikimet e nenit 113 pika 1 i ligjit 162/2020, “Për prokurimin publik” i ndryshuar. Nga ky moment operatorit ekonomik “GAMMA” SHPK mund të ushtrojë më pas të drejtën e ankimit për vendimin e dhënë në lidhje me ankesën për këtë procedurë prokurimi.

Komisioni i Prokurimit Publik (KPP), pas shqyrtimit të materialeve të fashikullit administrativ, konstaton se operatori ekonomik “GAMMA” SHPK, përmes shkresës me nr. 70101 prot., datë 09.06.2026, të dorëzuar me shërbim postar pranë KPP-së, ka paraqitur një shkresë me objekt: “Mbi vendimin e KSHA-së për pranimin e pjesshëm të ankesës së BOE “O.E.S DISTRIMED” SHPK & “EUROMED” SHPK dhe vendimin për skualifikimin e ofertës tonë”. Përmes kësaj shkrese, provohet se operatori ekonomik ka marrë dijeni rreth vendimit të KSHA-së, moment nga i cili fillon edhe afati ligjor për ushtrimin e së drejtës së ankimimit. Në rastin konkret, Komisioni konstaton se operatori “GAMMA” SHPK ka kryer shkelje të procedurës administrative, pasi nuk ka kryer pagesën e tarifës financiare për ankesën e mësipërme dhe nuk ka përdorur formularin përkatës të ankesës. Këto veprime vijnë në kundërshtim të plotë me përcaktimet e nenit 111 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se:

“1. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.

2. Ankesa bëhet sipas formularit përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete dhe bazën ligjore, ku ankuesi pretendon për shkeljet, pagesa e tarifës së ankesës, duke e shoqëruar atë me dokumentacionin dhe provat përkatëse, për të cilat mendon se mbështesin ankimin e tij. Elementet e sipërpërmendura janë të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës. Ankimuesi është i detyruar t'i bashkëlidhë ankimit dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën.

3. Nëse mungon ndonjë nga elementet e sipërpërmendura ose formulari nuk është plotësuar në mënyrën e duhur, atëherë autoriteti ose enti kontraktor duhet të vërë në dijeni ankimuesin për të plotësuar formularin. Njoftimi mund të bëhet me çdo mjet të mundshëm, përfshirë edhe postën elektronike, dhe në çdo rast dokumentohet. Nëse ankesa nuk korrigjohet brenda 2 ditëve nga njoftimi, ajo vlerësohet si e paparaqitur.

4. Në çdo rast, paraqitja e ankesës shoqërohet me mandatpagesën e bërë pranë Komisionit të Prokurimit Publik.”

III.1.11. Në gërmën “a” të pikës 2 të nenit 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, është parashikuar se: “2. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: a) të refuzojë ankesën për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj dhe mosrespektimit të afateve të ankimit, sipas parashikimeve të neneve 110 dhe 111 të këtij ligji”.

III.1.12. Referuar pikës 2 të nenit 111 të LPP-së, i ndryshuar, Komisioni thekson, se ligjvënësi ka përcaktuar disa elemente të domosdoshme formale për paraqitjen e ankesës, njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, sikurse është formulari përkatës dhe dokumenti bankar, që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën. Ndërsa referuar pikës 3 të nenit 111 të LPP-së, i ndryshuar, Komisioni gjykon, se ligjvënësi i ka dhënë një mundësi ankimuesve, që të korrigjojnë ankesat e tyre në rast se konstatohet mungesa e një apo më shumë elementeve formale të përcaktuara në pikën 2 të nenit 111 të LPP-së, i ndryshuar. Me anë të kësaj mundësie, ligjvënësi ka dashur të përcjellë frymën, se nuk mund t'i refuzohet e drejta e ankimit subjekteve që pretendojnë se dëmtohen ose rrezikojnë të dëmtohen nga një vendimmarrje e autoritetit kontraktor në mënyrë apriori, vetëm për shkak të disa mungesave formale, të cilat mund të korrigjohen lehtësisht brenda një afati të arsyeshëm, që nuk cenon parimin e efikasitetit në procedurat e prokurimit publik. Bazuar në dispozitën e mësipërme, për të konstatuar mungesat lidhur me elementet formale të ankesës, si dhe për të vënë në dijeni ankimuesin lidhur me mungesat e konstatuara, është detyrim i autoritetit kontraktor, i cili duhet të njoftojë menjëherë ankimuesin me çdo mjet të mundshëm, duke i lënë 2 ditë kohë për të korrigjuar elementet e domosdoshme formale të ankesës.

Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, se përcaktimi i procedurave të caktuara në LPP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga përgatitja e ofertës, shqyrtimi i ofertave, ankimi, si dhe mundësia për të korrigjuar mangësitë lidhur me elementet e domosdoshme formale të ankesës, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga

lex specialis LPP, janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementeve të mësipërme, lidhet ngushtësisht me elemente të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike.

Sa më sipër argumentuar, për sa kohë, kërkesa e paraqitur nga operatori ekonomik “GAMMA” SHPK pranë Komisionit Prokurimit Publik nuk plotëson kushtet formale, siç është formulari standard i ankesës, dorëzimi në sistemin elektronik të ankesave dhe pagesa e tarifës, rrjedhimisht kjo ankesë duhet refuzuar.

III.1.14. Sa më sipër, nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimes dhe nga verifikimi i vendimit të autoritetit kontraktor ku konstatohet se ky i fundit, ka vendosur pranim pjesërisht të ankesës së BOE “O.E.S DISTRIMED” SHPK & “EUROMED” SHPK, Komisioni përsa kohë që për këtë vendim të autoritetit kontraktor, ka patur pretendime nga subjekti i interesuar në përputhje me nenin 113 të Ligjit Nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar, por nuk ka ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti kontraktor vendosë që të mbyllë çështjen në lidhje me këtë pjesë të pranuar nga autoriteti kontraktor për ankesën me nr.1587 prot., datë 21.05.2026, të operatorit ekonomik BOE “O.E.S DISTRIMED” SHPK & “EUROMED” SHPK.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të BOE “O.E.S DISTRIMED” SHPK & “EUROMED” SHPK i cili kërkon skualifikimin e ofertës së paraqitura nga operatori ekonomik “GAMMA” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se nuk do të merren në shqyrtim, pasi referuar gjykimit më sipër për ekonomi të procedurës administrative nuk do të merren në shqyrtim pasi, gjendja faktike dhe juridike e operatorit ekonomik “GAMMA” SHPK do të vijojë të ngelet e skualifikuar edhe pas ankimit në KPP, duke mos pasur më interes të ligjshëm në lidhje me këtë procedurë prokurimi.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “*Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik*”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mbyll çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së BOE “O.E.S DISTRIMED” SHPK & “EUROMED” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me REF-77193-02-24-2026 me objekt: “Blerje materiale mjekimi konsumabel dhe kirurgjikale”, me fond limit 16,341,122.67 (gjashtëmbëdhjetë milion

e treqind e dyzetë e një mijë e njëqind e njëzetë e dy pikë gjashtëdhjetë e shtatë) Lek pa TVSH, zhvilluar në datën 05.05.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara

2. Autoriteti kontraktor të rivlerësojë procedurën sipas konstatimeve të shprehura në këtë vendim.
3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik BOE “O.E.S DISTRIMED” SHPK & “EUROMED” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi, i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

